



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 801/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.12.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me nr. REF-36196-09-17-2019, me objekt: “*Loti III – “Blerje bukë thekre dhe integrale”*”, me fond limit për njësi 235,000 lekë (pa TVSH) dhe vlerë të pritshme të kontratës 14,696,749 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.10.2019, nga autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Kadra” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Nënë Tereza”, Laknas, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë
Adresa: Rr. “Barrikadave”, Tiranë.
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k.
Adresa: Lagjia Qesarakë, godinë banimi dhe shërbimesh, kati I, Dajt, Tiranë.
- Baza Ligjore:** *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 18.09.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me nr. REF-36196-09-17-2019, me objekt: “*Loti III – “Blerje bukë thekre dhe integrale”*”, me fond limit për njësi 235,000 lekë (pa TVSH) dhe vlerë të pritshme të kontratës 14,696,749 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.10.2019, nga autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë.

II.2 Në datën 21.10.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 04.11.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|------------------------------|-------------------------------|
| 1. “Dajti Park 2007” sh.p.k. | 12,261,150 lekë, Kualifikuar; |
| 2. “Kadra” sh.p.k. | 14,341,800 lekë, Kualifikuar; |

II.4. Në datën 11.11.2019, operatori ekonomik “Kadra” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës

të paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Sa më sipër, në dijeninë e shoqërisë “KADRA” shpk, operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në këtë procedurë dhe konkretisht pikën 2.3.10, të Kriteve të Vecanta të kualifikimit ku kërkohet që “Operatori ekonomik duhet të paraqesë për secilin nga artikujt e lotit, mostrat me dëshmi të rezultateve të testimeve zyrtare (të leshuara nga institucione të autorizuar dhe të akredituara të kontrollit ose referencës, që vertetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike)”.

Bazuar në shkresën me Nr. 1455/6 Prot, të datës 03.07.2019 lëshuar nga Autoriteti kontraktor “Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë” për informacionin mbi kryerjen e analizave të produkteve ushqimore në ISUV, shprehimisht thuhet se: “Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme, që cdo artikull ushqimor që do të lëvrohet në magazinën e QEZHEF, të jetë i shoqëruar me raport analizat përkatëse të lëshuara nga ISUV. Duke marrë në konsideratë kërkesat e përcaktuara në tender sic jemi shprehur më lartë për pikën 2.3.10 dhe shkresën e autoritetit kontraktor, shoqëria “KADRA” shpk, duke qënë një kompani me eksperiencë në fushën e këtij objekt prokurimi, por edhe si një kompani që aktualisht operon nëpërmjet kontratës së shërbimit me institucionin e QEZHEF, ka hulumtuar dhe ka mundur të marrë informacionin që operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk nuk ka realizuar analizat për artikujt e kërkuara sipas specifikimeve teknike pranë institucionit të kërkuar nga vetë Autoriteti Kontraktor, por nga një laborator tjetër, i cili nuk përmbush kërkesat e vecanta për objektin e prokurimit dhe rëndësinë e vecantë që ka ky institucion dhe ky objekt prokurimi dhe konkretisht ashtu sic është kërkuar në specifikimet teknike të dokumenteve standarde të tenderit “Analiza për Treguesit fiziko-kimik të artikullit Bukë thekre dhe Buke integrale”. Gjatë hulumtimit tonë në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit rezultojnë vetëm dy laboratore të tjera për analizat e produkteve ushqimore përveç NOVAL, të cilat janë SCA Servizi Chimici Albanesi shpk dhe Laborator Bio-diagnostikues Veterinar BIO-V sh.p.k, por asnjëra prej këtyre laboratorëve nuk është e akredituar sipas fushave të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për kryerjen e analizave fiziko-kimike të produkteve ushqimore dhe më konkretisht për objektin e prokurimit në fjalë “BUKË THEKRE DHE INTEGRALE”. Për më tepër, duke u bazuar edhe në Urdhrin e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nr 524, datë 23.09.2019, është urdhëruar: -Autorizimi i NOVAL si laborator për kryerjen e analizave laboratorike për mostrat e marra gjatë kontrollit zyrtar dhe ky laborator është i akredituar dhe në krahasim me cdo laborator tjetër, përmbush realizimin e të gjitha mostrave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor sipas specifikimeve teknike. Në kuadër të parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe mosdiskriminimit të tyre, autoriteti kontraktor duhet të mbajë të njëjtën linjë gjykimi dhe qëndrimi, pasi për kërkesa të njëjta nuk mund të veprojë në mënyra të ndryshme duke e kualifikuar një operator ekonomik që nuk përmbush kriteret e përcaktuara në një procedurë prokurimi.

Shoqëria “KADRA” shpk, prej disa vitesh ushtron aktivitetin e saj në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore dhe rregulloret, ajo ka një ambjent të përshtatshëm i cili përmbush të gjitha kërkesat për këtë objekt prokurimi, në dallim nga operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk, i cili nuk plotëson kushtet dhe kërkesat e duhura për të ushtruar aktivitetin në një ambjent ashtu sic edhe kërkohet në këtë procedurë prokurimi. Arsyetojmë se duke qënë një objekt prokurimi i rëndësisë së vecantë, Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë ofertën e cila përmbush në mënyrë të plotë cdo kërkesë të vendosur në dokumentet standarde të tenderit dhe gjithashtu duhet të gjykojë ofertën duke marrë në konsideratë të gjitha kualifikimet, kapacitetet teknike dhe asetet e tjera fizike të nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate. Në rast të një gjykimi të padrejtë nga ana e Autoritetit Kontraktor, shoqëria “KADRA” shpk do të ndjekë cdo rrugë ligjore të mundshme në cdo organ

kompetent për të nxjerrë në pah pabarazinë që u bëhet operatorëve ekonomikë duke mbajtur qëndrime të ndryshme për kërkesa të njëjta, por edhe shumë të qarta e të pranuar nga Autoriteti Kontraktor sic theksohet edhe në shkresën tuaj bashkëlidhur kësaj ankese.[...]

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 2227/5 Prot. datë 14.11.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Kadra” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij, me arsyetimin si më poshtë vijon:

”[...] Për sa më sipër, kërkesa e AK për paraqitjen e analizave të këtyre treguesve, është e mbështetur në ligjin Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” si dhe në zbatim të Standardeve Shtetërore në fuqi për artikullin “Bukë thekre dhe integrale” (STASH 1411/87). Për sa i përket pretendimit të OE “KADRA” sh.p.k, në lidhje me akreditimin e laboratorëve ushqimorë që përmenden në ankesë, Ju sqarojmë si më poshtë:

‘NOVAL’ LABORATORY Shpk. Është Laborator i Akredituar me numër regjistrimi LT 084.

SCA Servizi Chimici Albanesi shpk Është Laborator i Akredituar me numër regjistrimi LT 061.

Laborator Bio-diagnostikues Veterinar BIO-V sh. p. k. Është Laborator i Akredituar me numër regjistrimi LT 058.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Është Laborator i Akredituar me numër regjistrimi LT 060.

Për secilin prej akreditimeve të mësipërme, bashkëlidhur Certifikatës së Akreditimit, në faqen e “Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimeve” gjenden dhe listat respektive të analizave, për të cilat është i vlefshëm ky akreditim. Theksojmë se, laboratorët e sipërcituar, për sa i përket vlefshmërisë apo akreditimit të kryerjes së analizave për treguesit fiziko-kimike, janë në kushte të njëjta.

Ashtu siç pretendohet në ankesën e OE: “Në kuadër të parimit të trajtimit të barabartë të OE dhe mosdiskriminimit të tyre, AK duhet të mbajë të njëjtën linjë gjykimi dhe qëndrimi, pasi për kërkesa të njëjta nuk mund të veprojë në mënyra të ndryshme duke kualifikuar një OE që nuk përmbush kriteret e përcaktuara në një procedurë prokurimi, Ju sqarojmë se, referuar pikërisht parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, KVO ka mbajtur qëndrim të njëjtë gjatë vlerësimit, për çdo OE konkurues. Për sa i përket këtij pretendimi, Ju sqarojmë si më poshtë: Referuar shkresës sonë nr.1455/6 datë 03.07.2019, ku citohet: “ISUV ka marrë në konsideratë mundësinë e ofriimit të shërbimit për kryerjen e analizave fiziko-kimike dhe mikrobiologjike për kontraktorët e QEZHEF për shkak të specifikës së veçantë që ka shërbimi i çerdheve dhe kopshteve” , sqarojmë se, OE “KADRA” sh.p.k, i është dhënë mundësia e kryerjes së analizave në ISUV, në cilësinë e Kontraktorit të QEZHEF dhe jo të Operatorit Ekonomik konkurues në këtë procedurë, për këtë arsye nuk përbën detyrim, zbatimin e kësaj shkrese dhe kryerja e analizave nga çdo OE konkurues (të cilët nuk kanë dijeni për këtë shkresë), vetëm në ISUV. Nëse OE “KADRA” sh.p.k, nuk do të ishte në cilësinë e kontraktorit të QEZHEF për vitin 2019, nuk do të kishte mundësi për kryerjen e analizave në ISUV dhe nuk do të ishte i favorizuar për kryerjen e këtyre analizave sikundër ka ndodhur. Nëse për këtë arsye, do të ishte skualifikuar OE “DAJTI PARK 2007” sh.p.k, nga ana e AK, do ishte cënuar parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit.

Referuar këtyre detyrimeve ligjore, nga KVO, është analizuar dhe verifikuar çdo dokumentacion i depozituar në SPE nga OE, si dhe pajtueshmëria e tyre me kriteret e kualifikimit. Konkretisht referuar DST, furra e bukës duhet të ketë të gjitha ambientet e përshtatshme për ruajtjen, magazinimin dhe prodhimin e bukës. Në lidhje me çdo OE, është verifikuar dhe analizuar për Furrën e bukës, dokumentacioni si më poshtë:

-Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Të kategorisë II.1.A.1: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve për njerëz.

-Leje Higjeno-Sanitare.

-Leje Mjedisore.

-Certifikata dezinfektimi për ambientin “Furre Buke”, për vitin 2019.

Janë Institucione të tjera, ato që monitorojnë dhe kanë kompetencë për verifikimin e kushteve fizike të ambjenteve të ushtrimit të aktivitetit, para lëshimit të dokumentacionit të sipërpërmendur. Gjithashtu theksojmë se, nuk është përcaktuar si kriter kualifikues në DST, verifikimi fizik i ambientit të ushtrimit të aktivitetit. Në të njëjtën mënyrë referuar verifikimit të dokumentacionit të depozituar në SPE, është bërë edhe vlerësimi dhe kualifikimi i OE “KADRA” sh.p.k, pra nuk është bërë verifikimi fizik i ambientit të ushtrimit të aktivitetit as për këtë OE [...]”

II.6.Në datën 20.11.2019, operatori ekonomik “Kadra” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.7.Në datën 03.12.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.2227/8prot., datë 02.12.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimes,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Kadra” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. me argumentin: “[...]operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk nuk ka realizuar analizat për artikujt e kërkuara sipas specifikimeve teknike pranë institucionit të kërkuar nga vetë Autoriteti Kontraktor, por nga një laborator tjetër, i cili nuk përmbush kërkesat e vecanta për objektin e prokurimit dhe rëndësinë e vecantë që ka ky institucion dhe ky objekt prokurimi dhe konkretisht ashtu sic është kërkuar në specifikimet teknike të dokumenteve standarde të tenderit “Analiza për Treguesit fiziko-kimik të artikullit Bukë thekre dhe Buke integrale”. Gjatë hulumtimit tonë në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit rezultojnë vetëm dy laboratore të tjera për analizat e produkteve ushqimore përveç NOVAL, të cilat janë SCA Servizi Chimici Albanesi shpk dhe Laborator Biodiagnostikues Veterinar BIO-V sh.p.k, por asnjëra prej këtyre laboratorëve nuk është e akredituar sipas fushave të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për kryerjen e analizave fiziko-kimike të produkteve ushqimore dhe më konkretisht për objektin e prokurimit në fjalë “BUKË THEKRE DHE INTEGRALE” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 (Loti III), pika 2.3.10, “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë për secilin nga artikujt e lotit, mostrat me deshmi të rezultateve të testimeve zyrtare (të leshuara nga institucione të autorizuar dhe të akredituara të kontrollit ose referencës, që vertetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike).”

III.1.2. Në shtojcën 10, “Specifikime teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

[...]6. Bukë thekre

Bazuar ne STASH 1411/87

Lloji: Bukë thekre me miell thekre, cilësi e parë.

Treguesit shqisorë

Pamja : E rregullt, pa shtypje, pa deformime, pa shenja djegie

Ngjyra : karakteristike e llojit te bukes se thekres kafe e erret.

Konsistenca: Elastike me shtypje të lehte, rikthehet ne gjendjen e parë, jo i thërrmueshëm dhe pa shtresa. Poret të jenë të shpërndara njëllon në të gjithë madhësinë.

Era dhe shija: e këndshme, e bukës së pjekur mirë. Pa erë e shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj.

Nuk lejohet kercitje.

Këto tregues percaktohen me anë të kontrollit organo-leptik.

Pesha e bukës të jetë 1 (një) kg.

Masa e caktuar sipas llojit të bukës duhet t'i përgjigjet masës 3-4 orë mbas kohës se pjekjes.

Lëndët e huaja: Nuk lejohen.

Treguesit fiziko – kimik:

Lagështira në % jo më shumë se 49.

Poroziteti në % jo më pak se 67.

Aciditeti në gradë jo më shumë se 7

Kripa në % jo më shumë se 2.

Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes.

Ambalazhimi: Buka ambalazhohet në qeska letre dhe kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore.

Buka duhet të jetë e prerë në feta.

Transporti: Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Buka e ambalazhuar në qeska letre duhet të transportohet në kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore, të cilat mund të marrin 10-15 bukë secila.

Buka duhet të shoqerohet me raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

7. Bukë integrale

Bazuar ne STASH 1411/87

Lloji: Bukë integrale me miell integral, cilësi e parë.

Treguesit shqisorë

Pamja : E rregullt, pa shtypje, pa deformime, pa shenja djegie

Ngjyra : karakteristike e llojit te bukes integrale kafe e erret.

Konsistenca: Elastike me shtypje të lehte, rikthehet ne gjendjen e parë, jo i thërrmueshëm dhe pa shtresa. Poret të jenë të shpërndara njëllon në të gjithë madhësinë.

Era dhe shija: e këndshme, e bukës së pjekur mirë. Pa erë e shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj.

Nuk lejohet kercitje.

Këto tregues percaktohen me anë të analizës organo-leptike.

Pesha e bukës të jetë 1 (një) kg.

Masa e caktuar sipas llojit të bukës duhet t'i përgjigjet masës 3-4 orë mbas kohës se pjekjes.

Lëndët e huaja: Nuk lejohen.

Treguesit fiziko – kimik:

Lagështira në % jo më shumë se 49.

Poroziteti në % jo më pak se 67.

Aciditeti në gradë jo më shumë se 7

Kripa në % jo më shumë se 2.

Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes.

Ambalazhimi: *Buka ambalazhohet në qeska letre dhe kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore.*

Buka duhet të jetë e prerë në feta.

Transporti: *Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.*

Buka e ambalazhuar në qeska letre duhet të transportohet në kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore, të cilat mund të marrin 10-15 bukë secila.

Buka duhet të shoqerohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara. [...]”

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konstatohet se operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar në mënyrë elektronike në SPE, si dhe në mënyrë fizike ditën e dorëzimit të mostrave, dokumentacionin si më poshtë:

- Raport Prove nr.19/4724, lëshuar nga laboratoriu BIO-V, për analizimin e produktit “Bukë Integrale”
- Raport Prove nr.19/4723, lëshuar nga laboratoriu BIO-V, për analizimin e produktit “Bukë Thekre”

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.1.5. Në nenin 30 të VKM nr. 914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*

III.1.6. Nga verifikimi i kryer, rezulton se laboratoriu testues “BIO-V”, i cili ka lëshuar raportet e provës për mostrat bukë integrale dhe bukë thekre, është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e

Akreditimit, me anë të certifikatës me numër regjistrimi LT058. Nga shqyrtimi i listës së analizave për të cilat është i vlefshëm akreditimi, Komisioni konstaton se, ky laborator është i akredituar për të kryer analiza laboratorike, për prodhime brumi për konsum human, vetëm për analiza mikrobiologjike dhe nuk është i akredituar për kryerjen e analizave fiziko-kimike (lagështirë, aciditet, porozitet, kripë etj.) sipas përcaktimeve të autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pavarësisht se ka lëshuar raporte prove fiziko-kimike për produktet e kërkuara. Në rastin konkretë, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k., nuk paraqitur dëshmi të rezultateve të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar dhe të akredituara të kontrollit ose referencës, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, e për pasojë ndodhemi në kushtet e mospërbushjes të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.10, të shtojcës 9 (Loti III), “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Komisioni thekson se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kadra” sh.p.k. qëndrojnë.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues ”Kadra” sh.p.k. për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë pasi operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. nuk përmbush kriteri e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kadra” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me nr. *REF-36196-09-17-2019*, me objekt: “*Loti III – “Blerje bukë thekre dhe integrale”*”, me fond limit për njësi 235,000 lekë (pa TVSH) dhe vlerë të pritshme të kontratës 14,696,749 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.10.2019, nga autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k., si dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kadra” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1776 protokolli Datë 20.11.2019;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha